

**M A R R E V E S H J E**  
**NDERMJET**  
**QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE**  
**DHE**  
**QEVERISE SE REPUBLIKES SE KROACISE**  
**PER ELEMINIMIN E TATIMEVE TE DYFISHTA ME**  
**TATIMET MBI TE ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN**

**Qeverija e Republikës së Shqipërisë**

**dhe**

**Qeveria e Republikës së Kroacisë**

duke dëshiruar të perfundojnë një Marrëveshje për eliminimin e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin,

kane rënë dakort për sa vijon:

**NENI 1**

**SUBJEKTET MBI TE CILAT ZBATOHET KONVENTA**

Kjo Marrëveshje do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njerit ose të të dy Shteteve Kontraktues.

## NENI 2

### TATIMET QE MBULON KONVENTA

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të vendosura në emër të një Shteti Kontraktues ose të autoriteteve të tij lokale, pamvarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat në total, mbi kapitalin në total, ose mbi elementë të të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë tatimet mbi rivleresimin e kapitalit dhe mbi fitimet nga shitblerja e pasurive të luajteshme ose të paluajteshme, si edhe tatimet mbi shumat totale të pagave të paguara nga sipërmarrjet.

3. Tatimet egzistuese ndaj të cilave do të zbatohet kjo Marrëveshje janë në veçanti:

a) Në Republikën e Kroacisë:

- (i) tatimi mbi fitimin,
- (ii) tatimi mbi të ardhurat;

(në vijim do t'i referohemi si "Tatimet Kroate")

b) Në Republikën e Shqipërisë:

- (i) tatimi mbi fitimet e personave juridikë;
- (ii) tatimet mbi aktivitetet e biznesit të vogël;
- (iii) tatimet mbi të ardhurat personale;
- (iv) tatimi mbi pasurinë.

(në vijim do t'i referohemi si "Tatimet Shqiptare")

4. Marrëveshja do të zbatohet gjithashtu për tatime të njëllojta ose tepër të ngjashme të cilat do të vendosen pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes si shtojcë ose në vend të tatimeve egzistuese, që i referohen paragrafit 3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njeri tjetrin për ndryshimet që janë bërë në ligjet përkatëse tatimore.

## NENI 3

### PERCAKTIME TE PERGJITHSHME

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshje, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

a) termi "Republika e Kroacisë", kur përdoret në sensin gjeografik,

nënkupton territorin e Republikës së Kroacisë brënda kufijve të saj ndërkombëtare të njohur, përfshirë çdo zonë tej ujrave territoriale të Republikës së Kroacisë e cila, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe me ligjet e Republikës së Kroacisë, është një zonë brenda të cilës Republika e Kroacisë ushtron të drejta lidhur me tabanin detar dhe nëntokën si dhe burimet e tyre natyrore;

a) termat "nje Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nenkuptojne Shqiperine ose Kroacinë siç e kerkon permbajtja;

b) termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë, dhe kur perdoret ne sensin gjeografik nenkupton territorin e Republikes se Shqiperise perfshire çdo zone tej ujrave territoriale te Republikes se Shqiperise e cila, ne perputhje me te drejten nderkombetare dhe me ligjet e Republikes se Shqiperise, eshte nje zone brenda se ciles Shqiperija mund te ushtroje te drejta lidhur me tabanin detar, nentoken dhe burimet e tyre natyrore;

c) termi "Kroacia" nenkupton Rumanine dhe, kur perdoret ne sensin gjeografik, nenkupton territorin e Rumanise perfshire ujrat e saj teritoriale si edhe zonen ekonomike eskluzive mbi te cilen Rumanija ushtron sovranitetin, te drejtat sovrane, ose juridiksionin ne perputhje me ligjin e saj te brendshem dhe me te drejten nderkombetare, lidhur me zbulimin dhe shfrytzymin e burimeve natyrore, biologjike dhe minerare qe ekzistojne ne ujrat detare, tabanin detar dhe nentoken e ketyre ujrave;

d) termi "tatim" nenkupton tatimin Shqiptar ose tatimin Rumun siç e kerkon permbajtja;

e) termi "person" perfshin nje individ, nje kompani dhe çdo grup tjetër personash te krijuar ne perputhje me ligjet ne sejcilin Shtet Kontraktues;

f) termi "shoqeri" (kompani) nënkupton çdo trup korporativ (shoqëri tregtare) ose çdo person ligjor qe trajtohet si person juridik per qellime tatimore;

g) termat "sipermarrje e nje Shteti Kontraktues" dhe "sipermarrje e Shtetit tjetër Kontraktues" nenkuptojne respektivisht nje sipermarrje te ushtruar nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues dhe nje sipermarrje te ushtruar nga nje rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

h) termi "nenshtetas" nenkupton:

(i) çdo individ qe zoteron nenshtetesine e nje Shteti Kontraktues;

(ii) çdo person juridik, ose shoqeri qe gezon statusin si e tille ne perputhje me ligjet ne fuqi ne nje Shtet Kontraktues;

i) termi "transport nderkombetar" nenkupton çdo transport me

anije, hekurudhe, mjet fluturues apo mjet te transportit rrugor qe kryhet nga nje sipermarrje qe ka qendren e drejtimit efektiv ne nje Shtet Kontraktues, pervec kur nje transport i tille vepron vetem brendaperbrenda Shtetit tjeter Kontraktues;

j) termi "autoritet kompetent" nenkupton:

(i) ne rastin e Shqiperise, Ministrin e Financave ose perfaqsesin e autorizuar prej tij;

(ii) ne rastin e Rumanise Ministrin e Financave ose perfaqsesin e autorizuar prej tij.

2. Persa i perket zbatimit te kesaj Konvente nga nje Shtet Kontraktues çdo term i pa percaktuar ketu, perderisa permbajtja te mos e kerkoje ndryshe, do te kete kuptimin qe i eshte dhene sipas legjislacionit te atij Shteti lidhur me tatimet e te cilit zbatohet Konventa.

#### **NENI 4**

##### **REZIDENTI**

1. Per qellime te kesaj Konvente, termi "rezident i nje Shteti Kontraktues" nenkupton çdo person qe, sipas ligjeve te atij Shteti, eshte subjekt i tatimeve atje per shkak te vendbanimit, rezidences, vendit te drejtimit apo çdo kriteri tjeter te nje natyre te ngjashme. Por ky term nuk perfshin personat qe i neneshtrohen tatimeve ne njerin Shtet lidhur vetem me te ardhurat qe ai realizon nga burime brenda ketij Shteti ose nga kapitali i vendosur aty.

2. Kur per shkak te dispozitave te paragrafit 1 nje individ eshte rezident i te dy Shteteve Kontraktues atehere statusi i tij do te percaktohet si vijon:

a) ai do te konsiderohet rezident i Shtetit Kontraktues ne te cilin ai ka nje banese te perhereshme ne dispozicion te tij; Neqoftese ai ka nje banese te perhereshme ne dispozicion te tij ne te dy Shtetet Kontraktuese, ai do te konsiderohet rezident i Shtetit Kontraktues me te cilin interesat e tij personale dhe ekonomike jane te lidhura me ngushte (qendra e interesave jetike);

b) neqoftese Shteti Kontraktues ne te cilin ai ka qendren e interesave jetike nuk mund te percaktohet, ose neqoftese ai nuk ka nje banese te perhereshme ne dispozicion te tij ne asnjerin Shtet, ai do te konsiderohet rezident i Shtetit ne te cilin ai qendron zakonisht;

c) neqoftese ai qendron rregullisht ne te dy Shtetet ose ne asnjerin prej tyre, ai do te konsiderohet rezident i Shtetit ne te cilin ai eshte nenshtetas;

d) neqoftese ai eshte nenshtetas i te dy Shteteve ose i asnjerit prej tyre, autoritetet kompetente te Shteteve Kontraktues do ta

zgjidhin kete çeshtje me mirekuptim reciprok.

3. Kur per shkak te dispozitave te paragrafit 1 nje person jo individ (person juridik) eshte rezident i te dy Shteteve Kontraktues, atehere ai do te konsiderohet rezident i Shtetit ne te cilin eshte vendosur qendra e drejtimit efektiv te ketij personi.

## **NENI 5**

### **SELI E PERHERESHME**

1. Per qellime te kesaj Konvente, termi "seli (perfaqsi) e perhereshme" nenkupton nje vend fiks biznesi nepermjet te cilit ushtrohet teresisht ose pjesisht aktiviteti i siper marrjes.

2. Termi "seli e perhereshme" perfshin ne veçanti:

- a) nje vend drejtimi;
- b) nje dege;
- c) nje zyre;
- d) nje fabrike;
- e) nje punishte;
- f) nje ferme, plantacion, punishte ose vreshte; dhe
- g) nje miniere, nje pus nafte ose gazi ose çdo vend tjeter per shfrytzimin e burimeve natyrore.

3. Termi "Seli e perhereshme" do te perfshije gjithashtu:

a) nje shesh ndertimi, nje konstruksion, projekt montimi apo instalimi ose projekte mbikqyrjeje te lidhura me to, por vetem kur nje shesh i tille, projekte apo aktivitete vazhdojne per nje periudhe prej me shume se 9 (nente) muajsh brenda çdo periudhe 12 mujore;

b) kryerja e sherbimeve, perfshire sherbimet konsultative, nga nje siper marrje e nje Shteti Kontraktues nepermjet te punesuarve apo edhe personeli tjeter te perfshire ne keto sherbime ne Shtetin tjeter Kontraktues, me kusht qe aktivitete te tilla te vazhdojne, per te njejtin projekt ose nje projekt te lidhur me te, per nje periudhe ose periudha qe ne total i kalojne 9 (nente) muaj brenda çdo periudhe 12 mujore;

4. Pamvaresisht nga dispozitat e mesiperme te ketij Neni, termi "seli e perhereshme" nuk do te perfshije:

a) perdorimin e paisjeve apo objekteve vetem per qellime magazinimi, ekspozimi ose te shperndarjes se mallrave qe i perkasin siper marrjes;

b) mbajtjen e nje gjendje mallrash qe i perkasin sipermarrjes vetem per qellime magazinimi, ekspozimi apo shperndarje;

c) mbajtjen e nje gjendje mallrash qe i perkasin sipermarrjes vetem per qellime perpunimi nga nje sipermarrje tjeter;

d) shitja e mostrave te mallrave qe i perkasin sipermarrjes te ekspozuara ne kuadrin e nje panairi apo ekspozite te perkoheshme, pas mbylljes se ketij panairi apo ekspozite;

e) mbajtja e nje vendi fiks biznesi vetem me qellim blerjen e mallrave ose per mbledhje informacioni per sipermarrjen;

f) mbajtja e nje vendi fiks biznesi vetem per qellim te ushtrimit per sipermarrjen te çdo aktiviteti tjeter me karakter pregatitor ose ndihmes.

5. Pamvaresisht nga dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2, kur nje person - i ndryshem nga nje agjent me status te pavarur ndaj te cilit zbatohet paragrafi 6 - vepron ne nje Shtet Kontraktues ne emer te nje sipermarrje te Shtetit tjeter Kontraktues, kjo sipermarrje do te konsiderohet se ka nje seli te perhereshme ne Shtetin e permendur ne fillim lidhur me çdo aktivitet qe ai person ndermerr per sipermarrjen, nese ky person:

a) ka dhe zakonisht ushtron ne ate shtet nje autoritet per te perfunduar kontrata ne emer te sipermarrjes, perveç kur aktivitetet e ketij personi kufizohen ne ato te permendura ne paragrafin 4 qe, nese ushtrohen nepermjet nje vendi fiks biznesi, nuk do ta benin kete vend fiks biznesi nje seli te perhereshme sipas dispozitave te atij paragrafi, ose

b) nuk ka nje autoritet te tille, por zakonisht mban ne Shtetin e permendur ne fillim nje gjendje mallrash nga ku ai shperndan rregullisht mallra ne emer te sipermarrjes, ose

c) ai siguron porosi ne Shtetin e permendur ne fillim, teresisht ose thujse teresisht per vete sipermarrjen apo per sipermarrje te tjera qe kontrollohen prej saj , ose kane interesa kontrolli ne te.

6. Nje sipermarrje e nje Shteti Kontraktues nuk do te konsiderohet se ka nje seli te perhereshme ne Shtetin tjeter Kontraktues vetem per faktin se ajo ushtron biznesin ne kete Shtet tjeter nepermjet nje ndermjetesi, komisioneri te pergjithshem apo çdo lloj agjenti tjeter me nje status te pavarur, me kusht qe te tille persona veprojne brenda kuadrit te zakonshem te aktivitetit te tyre. Sidoqofte, kur aktivitetet e nje agjenti te tille kryhen teresisht ose thujse teresisht ne emer te asaj sipermarrje, ai nuk do te konsiderohet nje agjent me nje status te pavarur brenda kuptimit te ketij paragrafi.

7. Fakti qe nje shoqeri qe eshte rezidente e nje Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga nje shoqeri qe eshte rezidente e

Shtetit tjetër Kontraktues, ose që ushtron aktivitet në atë Shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose në formë të tjera) nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për të konsideruar njëri shqerori seli të përhershme të tjetrit.

## **NENI 6**

### **TE ARDHURAT NGA PASURIA E PATUNDESHME**

1. Te ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuria e patundeshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të taten në këto Shtet tjetër.

2. Termi "pasuri e patundeshme" do të këto kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast ky term do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së patundeshme, inventarin e gjallë dhe paisjet e përdorura në bujqësi e në pyje, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e të drejtës private lidhur me pronën mbi token, uzufukti i pasurive të patundeshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose variabël për shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar vendburimet minerare dhe burime të pasurisë të tjera natyrore. Anijet, avjonet, mjetet e transportit hekurudhor dhe rrugor nuk konsiderohen pasuri e patundeshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira, ose përdorimi në çdo formë tjetër të pasurive të patundeshme.

4. Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e patundeshme e një sipërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e patundeshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

## **NENI 7**

### **FITIMET NGA BIZNESI I SIPERMARRJEVE**

1. Fitimet e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të taten vetëm në atë Shtet përveç kur sipërmarrja ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty. Nëqoftesë sipërmarrja ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërperëndur, fitimet e sipërmarrjes mund të taten në Shtetin tjetër por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet:

a) asaj selije të përhershme;

b) shitjeve në atë Shtet tjetër të mallrave njelloj si shitjet nëpërmjet selisë së përhershme;

c) aktiviteteteve te tjera te biznesit te ushtruara ne ate Shtet tjeter ne te njejten menyre si ato te ushtruara nepermjet selise se perhereshme.

2. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 3, kur nje siper marrje e nje Shteti Kontraktues ushtron biznes ne Shtetin tjeter Kontraktues nepermjet nje selie te perhereshme te vendosur aty, atehere ne secilin Shtet Kontraktues selise se perhereshme do t'i atribuohen fitimet qe ajo do te realizonte sikur ajo te ishte nje siper marrje e veçante dhe e pavarur qe do te vepronte ne te njejtin aktivitet ose ne aktivite te ngjashme, nen kondita te njejta ose te ngjashme, teresisht e pavarur nga siper marrja seli e perhereshme e se ciles ajo eshte.

3. Ne percaktimin e fitimeve te nje selie te perhereshme lejohet zbritja e shpenzimeve qe jane kryer per qellimet e selise se perhereshme, perfshire shpenzimet e pergjithshme administrative dhe ekzekutive si ne Shtetin ku ndodhet selia e perhereshme ashtu edhe gjetke. Kjo dispozite do te zbatohet bazuar ne kufizimet sipas legjislacionit te brendshem te Shtetit Kontraktues ku eshte vendosur selija e perhereshme.

4. Ne rast se njeri prej Shteteve Kontraktuese ne percaktimin e fitimeve qe i atribuohen nje selie te perhereshme ndjek zakonisht metoden e ndarjes se fitimeve te pergjithshme te siper marrjes midis pjeseve te veçanta te saj, dispozitat e paragrafit 2 nuk e pengojne ate Shtet Kontraktues te percaktoje fitimet e tatueshme ne baze te kesaj metode, megjithate, rezultati i kesaj metode duhet te jete konform parimeve qe permbahen ne kete Nen.

5. Asnje fitim nuk mund t'i atribuohet nje selie te perhereshme vetem per faktin se ajo blen mallra per siper marrjen.

6. Ne funksion te paragrafeve te meparshem, fitimet qe i atribuohen nje selie te perhereshme do te percaktohen me te njejten metode çdo vit perderisa te mos egzistojne arsye te forta dhe te mjaftueshme per te proceduar ndryshe.

7. Kur fitimet permbajne elemente te te ardhurave qe trajtohen veças ne Nene te tjera te kesaj Konvente, atehere dispozitat e atyre Neneve nuk do te ndikohen nga dispozitat e ketij Neni.

## **NENI 8**

### **TRANSPORTI NDERKOMBETAR**

1. Fitimet nga veprimtaria ne transportin nderkombetar te anijeve, avjoneve apo mjeteve te transportit rrugor do te taten vetem ne Shtetin Kontraktues ku eshte vendosur vendi i drejtimit efektiv te siper marrjes.

2. Nese vendi i drejtimit efektiv te nje siper marrje te transportit detar eshte ne bordin e nje anije, atehere ajo do te konsiderohet



e vendosur ne Shtetin Kontraktues ne te cilin ndodhet porti ku anija qendron rregullisht, ose, nese nuk ka te tille qendrim, ne Shtetin Kontraktues rezident i te cilit eshte perdoruesi i anijes.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do te zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve nga pjesmarrja ne nje bashkesi, nje biznes te perbashket apo ne nje agjensi nderkombetare transporti.

## **NENI 9**

### **SIPERMARRJE TE LIDHURA**

1. Kur:

a) nje sipermarrje e nje Shteti Kontraktues merr pjese direkt ose indirekt ne drejtimin, kontrollin ose kapitalin e nje sipermarrje te Shtetit tjeter Kontraktues, ose

b) te njejtet persona marrin pjese direkt ose indirekt ne drejtimin, kontrollin apo kapitalin e nje sipermarrje te nje Shteti Kontraktues dhe te nje sipermarrje te Shtetit tjeter Kontraktues,

dhe ne secilin rast kushtet qe jane pranuar ose qe jane diktuar midis dy sipermarrjeve ne mardhenjet e tyre tregtare apo financiare ndryshojne nga ato qe do te vendoseshin midis sipermarrjeve te pavarura, atehere çdo fitim qe do te realizohej nga njera sipermarrje, por qe per shkak te konditave te veçanta te permendura ne fillim nuk eshte realizuar, mund te perfshihet ne fitimet e asaj sipermarrje dhe te tatohet normalisht.

2. Kur nje Shtet Kontraktues perfshin ne fitimet e nje sipermarrje te atij Shteti - dhe i taton ato normalisht - fitime per te cilat nje sipermarrje e Shtetit tjeter Kontraktues eshte renduar me tatim ne ate Shtet tjeter dhe fitimet e perfshira ne kete menyre jane fitime qe do te ishin realizuar nga sipermarrja e Shtetit te permendur ne fillim nese konditat e krijuara midis dy sipermarrjeve kane qene ato qe do te vendoseshin midis sipermarrjeve te pavarura, atehere ai Shtet tjeter do te beje nje rregullim ne masen e duhur te shumes se tatimit te vendosur mbi keto fitime. Ne percaktimin e rregullimeve te tilla duhet t'i kushtohet vemendje edhe dispozitave te tjera te kesaj Konvente dhe autoritetet kompetente te Shteteve Kontraktuese, ne rast nevojje, mund te konsultohen me njeri tjetrin.

## **NENI 10**

### **DIVIDENTET**

1. Dividentet e paguar nga nje kompani qe eshte rezidente e nje Shteti Kontraktues nje rezidenti te Shtetit tjeter Kontraktues

mund te tatohen ne kete Shtet tjeter.

2. Megjithate, te tille dividente mund te tatohen gjithashtu ne Shtetin Kontraktues rezidente e te cilit eshte kompania paguese e dividenteve dhe ne perputhje me ligjet e ketij Shteti, por nese marresi eshte pronari perfitues i dividenteve tatimi i ngarkuar nuk do te kaloje:

a) 10 perqind te shumes bruto te dividenteve nese pronari perfitues eshte nje kompani (jo ortakeri) qe zoteron direkt te pakten 25 perqind te kapitalit te kompanise paguese te dividenteve;

b) 15 perqind te shumes bruto te dividenteve ne te gjitha rastet e tjera.

Ky paragraf nuk do te kete efekt mbi tatimin e kompanise lidhur me fitimet nga te cilat jane paguar dividendet.

3. Ne funksion te ketij Neni, termi "dividente" nenkupton te ardhurat nga aksionet, aksione te minierave ose te drejta te tjera, aksione themelimi qe nuk jane kerkesa borxhi, pjesmarrja ne fitime, si edhe te ardhurat nga te drejta te tjera korporative qe i neneshtrohen te njejtimit trajtim tatimor si te ardhurat nga aksionet nga ligjet e Shtetit rezidente e te cilit eshte kompania qe ben shperndarjen e dividenteve.

4. Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 nuk do te zbatohen nese pronari perfitues i dividenteve, duke qene rezident i nje Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet ne Shtetin tjeter Kontraktues rezidente e te cilit eshte kompania paguese e dividenteve, nepermjet nje selie te perhereshme te vendosur aty, ose kryen ne ate Shtet tjeter sherbime personale te pavarura nga nje baze fikse e vendosur aty, dhe zoterimi lidhur me te cilin jane paguar dividendet eshte efektivisht i lidhur me kete seli te perhereshme ose baze fikse. Ne kete rast do te zbatohen dispozitat e neneve 7 ose 14, si te paraqitet rasti.

5. Kur nje kompani qe eshte rezidente e nje Shteti Kontraktues realizon fitime ose te ardhura nga Shteti tjeter Kontraktues, ky Shtet tjeter nuk zbaton tatim mbi dividendet e paguar nga kompania, pervec kur keto dividente i paguhen nje rezidenti te Shtetit tjeter ose kur zoterimi lidhur me te cilin jane paguar dividendet eshte efektivisht i lidhur me nje seli te perhereshme ose baze fikse te vendosur ne kete Shtet tjeter. Subjekt i tatimit nuk jane gjithashtu as fitimet e pashperndara te kompanise, edhe sikur dividendet e paguar ose fitimet e pashperndara konsistojne teresisht ose pjeserisht si fitime apo te ardhura te realizuara ne kete Shtet tjeter.

## **NENI 11**

### **INTERESAT**

1. Interesat qe krijohen ne nje Shtet Kontraktues dhe i paguhen

nje rezidenti te Shtetit tjeter Kontraktues mund te tatohen ne kete Shtet tjeter.

2. Megjithate, keto interesa mund te tatohen edhe ne Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe ne perputhje me ligjet e ketij Shteti, por kur marresi eshte pronari perfitues i interesave tatimi i zbatuar nuk duhet te kaloje 10 perqind te shumes bruto te interesit.

3. Pamvaresisht nga dispozitat e paragrafit 2 te ketij Neni, interesat e krijuara ne nje Shtet Kontraktues dhe te perfituara nga Qeverija e Shtetit tjeter Kontraktues do te perjashtohen nga tatimi ne Shtetin e permendur ne fillim.

4. Per qellimet e paragrafit 3, termi "Qeveri" do te perfshije:

a) ne rastin e Shqiperise:

- (i) Qeverine e Shqiperise;
- (ii) Autoritetet lokale;
- (iii) Banken e Shqiperise;
- (iv) Banken Kombetare Tregtare;
- (v) institucione te tilla, kapitali i te cilave zoterohet teresisht nga Qeverija e Shqiperise ose autoritetet lokale, qe mund te bihet dakord kohe pas kohe midis autoriteteve kompetente te Shteteve Kontraktuese;

b) ne rastin e Rumanise:

- (i) Qeverine e Rumanise;
- (ii) Njesite administrative territoriale (autoritetet lokale);
- (iii) Banken Kombetare te Rumanise;
- (iv) Banken e Eksport Importit (Eximbank of Romania);
- (v) institucione te tilla, kapitali i te cilave zoterohet teresisht nga Qeverija e Rumanise ose njesite administrative territoriale, qe mund te bihet dakort kohe pas kohe midis autoriteteve kompetente te Shteteve Kontraktuese.

5. termi "interesa" ne kuptimin e perdorur ne kete Nen nenkupton te ardhurat nga kerkesat e borxhit te çdo lloji, te siguruara ose jo me hipotekim ndaj pasurive, dhe qe e kane ose jo te drejten e pjesmarrjes ne fitimet e debitorit dhe ne veçanti, te ardhurat nga obligacionet shteterore dhe lloje te tjera letrash me vlere, perfshire edhe fitimet apo shperblimet qe rrjedhin nga keto obligacione apo letra me vlere. Gjohet e ngarkuara per pagesa te

vonuara nuk do te konsiderohen si interesa per qellime te ketij Neni.

6. Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 nuk do te zbatohen neqoftese marresi i interesave, duke gene nje rezident i nje Shteti Kontraktues, ushtron biznes ne Shtetin tjeter Kontraktues ku krijohen (lindin) interesat, nepermjet nje selie te perhereshme te vendosur aty, ose kryen ne ate Shtet tjeter sherbime personale te pavarura nga nje baze fikse e vendosur aty, dhe kerkesa e huase lidhur me te cilen paguhet interesi eshte efektivisht e lidhur me kete seli te perhereshme ose baze fikse. Ne kete rast do te zbatohen dispozitat e nenit 7 ose 15, si te paraqitet rasti.

7. Interesat do te konsiderohen se krijohen ne nje Shtet Kontraktues kur paguesi eshte vete ai Shtet, nje autoritet lokal ose nje rezident i atij Shteti. Megjithate, kur personi qe paguan interesat, qofte ose jo rezident i njerit Shtet Kontraktues, ka ne njerin Shtet Kontraktues nje seli te perhereshme ose nje baze fikse ne lidhje me te cilen ka lindur huaja per te cilen paguhet interesi, dhe keto interesa krijohen nga selia e perhereshme ose nga baza fikse, atehere interesat do te konsiderohen se jane krijuar ne Shtetin ku eshte vendosur selia e perhereshme ose baza fikse.

8. Kur per shkak te mardhenjeve te veçanta midis paguesit dhe pronarit perfitues te interesave ose midis te dyve dhe personave te trete, shuma e interesave, bazuar ne huane per te cilen paguhen, e kalon shumen mbi te cilen duhej te ishte rene dakort midis paguesit dhe pronarit perfitues ne mungese te mardhenjeve te tilla, dispozitat e ketij Neni do te zbatohen vetem mbi shumen e permendur ne fund. Ne kete rast, pjesa qe kalon pagesen normale do te mbetet e tatueshme ne perputhje me ligjet e sejcilit Shtet, duke patur parasysh edhe dispozitat e tjera te kesaj Konvente.

## **NENI 12**

### **KOMISIONET**

1. Komisionet qe krijohen ne nje Shtet Kontraktues dhe i paguhen nje rezidenti te Shtetit tjeter Kontraktues mund te taten ne kete Shtet tjeter.

2. Megjithate, keto komisione mund te taten gjithashtu ne Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe ne perputhje me ligjet e atij shteti, por neqoftese marresi eshte pronari perfitues i komisioneve, tatimi i ngarkuar ne kete rast nuk do te kaloje 15 perqind te shumes bruto te komisionit.

3. Termi "komisione" sipas perdorimit ne kete Nen nenkupton nje pagese qe i behet nje ndermjetesit, agjenti komisioner te pergjithshem ose çdo personi te perfshire ne aktivitete te ngjashme ne perputhje me ligjet tatimore te Shtetit Kontraktues ne te cilin lindin keto pagesa.

4. Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 nuk do te zbatohen nese pronari perfitues i komisioneve, duke qene nje rezident i nje Shteti kontraktues, ushtron biznes ne Shtetin tjeter Kontraktues ne te cilin krijohen komisionet, nepermjet nje selije te perhereshme te vendosur aty, ose kryen ne ate Shtet tjeter sherbime personale te pavarura nga nje baze fikse te vendosur aty, dhe e drejta ose prona lidhur me te cilen jane paguar komisionet eshte efektivisht e lidhur me kete seli te perhereshme ose baze fikse. Ne rast te tille do te zbatohen dispozitat e neneve 7 dhe 15, si te paraqitet rasti.

5. Komisionet do te konsiderohen se krijohen ne nje Shtet Kontraktues kur pagues eshte vete ai Shtet, nje autoritet lokal ose nje rezident i atij Shteti. Megjithate, kur personi qe paguan komisionet, qofte ose jo rezident i nje Shteti Kontraktues, ka ne njerin Shtet kontraktues nje seli te perhereshme apo nje baze fikse lidhur me te cilen jane kryer aktivitetet per te cilat eshte kryer pagesa, dhe keto komisione kane lindur nga kjo seli e perhereshme ose baze fikse, atehere keto komisione do te konsiderohen se kane lindur ne Shtetin Kontraktues ku eshte vendosur selija e perhereshme ose baza fikse.

6. Kur per shkak te mardhenjeve te veçanta midis paguesit dhe pronarit perfitues ose midis te dyve dhe personave te trete, shuma e komisionit, duke patur parasysh aktivitetet per te cilat ai eshte paguar, e kalon shumen per te cilen do te bihej dakord midis paguesit dhe pronarit perfitues ne mungese te mardhenjeve te tilla, dispozitat e ketij Neni do te zbatohen vetem ndaj shumes se permendur ne fund. Ne rast te tille, pjesa qe kalon pagesen do te mbetet e tatueshme ne perputhje me ligjet e sejcilit Shtet Kontraktues, duke patur parasysh dispozitat e tjera te kesaj Konvente.

### **NENI 13**

#### **TE ARDHURAT NGA E DREJTA E AUTORIT (HONORARET)**

1. Te ardhurat nga e drejta e autorit (honoraret) qe krijohen ne nje Shtet Kontraktues dhe i paguhen nje rezidenti te Shtetit tjeter Kontraktues mund te taten ne kete Shtet tjeter.

2. Megjithate, keto te ardhura mund te taten gjithashtu ne Shtetin Kontraktues ku krijohen dhe ne perputhje me ligjet e ketij Shteti, por nese marresi eshte pronari perfitues i honorareve, tatimi i ngarkuar nuk duhet te kaloje 15 perqind te shumes bruto te honorarit.

3. Termi "Honorare" nen dispozitat e ketij Neni nenkupton çdo te ardhur te marre si pagese per perdorimin ose te drejten e perdorimit te se drejtes se autorit per punimet letrare, artistike ose shkencore, perfshire filmat kinematografike dhe filmat, kasetat e videokasetat per trasmetime radio- televizive, trasmetimet me satelit ose kabell per publikun nepermjet çdo forme te medias elektronike, çdo patente, marke tregtare, skice ose model, plan, proces ose formule sekrete, ose per perdorimin ose te drejten e perdorimit te paisjeve industriale, tregtare apo shkencore ose te

informacioneve lidhur me eksperiencen industriale tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 nuk do te zbatohen nese pronari perfitues i honorareve, duke qene rezident i nje Shteti Kontraktues, ushtron biznes ne Shtetin tjeter Kontraktues ku krijohen honoraret nepermjet nje selie te perhereshme te vendosur aty, ose kryen ne ate Shtet tjeter sherbime personale te pavarura nepermjet nje baze fikse te vendosur aty, dhe e drejta ose prona lidhur me te cilen paguhen honoraret eshte efektivisht e lidhur me kete seli te perhereshme ose baze fikse. Ne keto raste do te zbatohen dispozitat e neneve 7 ose 15, si te paraqitet rasti.

5. Honoraret do te konsiderohet se krijohen ne nje Shtet Kontraktues kur pagues eshte vete ai Shtet, nje autoritet lokal ose nje rezident i atij Shteti. Megjithate, kur personi qe paguan honoraret, qofte ose jo rezident i nje Shteti Kontraktues, ka ne njerin Shtet Kontraktues nje seli te perhereshme ose baze fikse me te cilen eshte e lidhur e drejta e pagimit te honorareve, dhe keto honorare kane lindur nga kjo seli e perhereshme ose baze fikse, atehere keto honorare konsiderohen se kane lindur ne Shtetin Kontraktues ku eshte vendosur selija e perhereshme ose baza fikse.

6. Kur per shkak te mardhenjeve te vecanta midis paguesit dhe pronarit perfitues ose midis te dyve dhe personave te trete, shuma e honorareve, duke patur parasysh perdorimin, te drejten apo informacionin per te cilin ato jane paguar, e kalon shumen per te cilen do te ishte rene dakort midis paguesit dhe pronarit perfitues ne mungese te mardhenjeve te tilla, atehere dispozitat e ketij Neni do te zbatohen mbi shumen e permendur ne fund. Ne nje rast te tille shuma e shperblimit qe kalon shperblimin normal mbetet e tatueshme sipas ligjeve perkatese te sejcilit Shtet Kontraktues, duke patur parasysh dispozitat e tjera te kesaj Konvente.

#### **NENI 14**

##### **FITIMET NGA TJETERSIMI I KAPITALIT**

1. Fitimet e realizuara nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues nga tjetersimi i pasurive te patundeshme qe i referohen Nenit 6 dhe te vendosura ne Shtetin tjeter Kontraktues mund te taten ne kete Shtet tjeter.

2. Fitimet nga tjetersimi i pasurive te tundshme qe bejne pjese ne pasurite e biznesit te nje selie te perhereshme qe nje sipermarrje e nje Shteti Kontraktues ka ne Shtetin tjeter Kontraktues ose i pasurive te tundeshme qe i perkasin nje baze fikse qe nje rezident i nje Shteti Kontraktues ka ne Shtetin tjeter Kontraktues per te kryer sherbime personale te pavarura, perfshire edhe fitimet nga tjetersimi i vete selise se perhereshme (vetem ose bashke me sipermarrjen) ose i baze fikse, mund te taten ne kete Shtet tjeter.

3. Fitimet e realizuara nga tjetersimi i anijeve, avioneve ose mjeteve te transportit hekurudhor dhe rrugor qe veprojne ne trafikun nderkombetar ose i pasurive te tundeshme qe i perkasin veprimtarise se ketyre mjeteve te transportit do te tatohen vetem ne Shtetin Kontraktues, ne te cilin eshte vendosur qendra e drejtimit efektiv te sipermarrjes.

4. Fitimet nga tjetersimi i çdo pasurie qe nuk mbulohet nga paragrafet 1, 2 dhe 3 do te tatohen vetem ne Shtetin Kontraktues rezident i te cilit eshte tjetersuesi.

## **NENI 15**

### **SHERBIMET PERSONALE TE PAVARURA**

1. Te ardhurat e realizuara nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues lidhur me sherbimet profesionale ose aktivitetete te tjera te nje karakteri te pavarur do te tatohen vetem ne ate Shtet perveç kur ai ka nje baze fikse ne Shtetin tjeter Kontraktues qe rregullisht i sherben atij per te kryer keto aktivitetete. Nese ai ka nje baze te tille fikse, te ardhurat mund te tatohen ne Shtetin tjeter por vetem ne masen qe i atribuohen kesaj baze fikse.

2. Termi "sherbime profesionale" perfshin ne veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore apo mesimdhenjeje si dhe aktivitetet e pavarura te mjekeve, dentisteve, avokateve, inxhinjereve, arkitekteve dhe llogaritareve.

## **NENI 16**

### **SHERBIMET PERSONALE TE VARURA**

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 17, 19, 20, 21 dhe 22, pagat dhe shperblime te tjera te ngjashme qe perfitohen nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues nga punesimi i tij do te tatohen vetem ne kete Shtet Kontraktues, perveç kur puna eshte ushtruar ne Shtetin tjeter Kontraktues. Nese puna ushtrohet ne Shtetin tjeter Kontraktues, atehere keto te ardhura mund te tatohen ne kete Shtet tjeter.

2. Pamvaresisht nga dispozitat e paragrafit 1, shperblimet e perfituara nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues lidhur me punen e ushtruar ne Shtetin tjeter Kontraktues do te tatohen vetem ne Shtetin e permendur ne fillim, neqoftese:

a) perfituesi (marresi) eshte prezent ne Shtetin tjeter per nje periudhe ose periudha qe nuk i kalojne ne total 183 dite ne çdo periudhe 12 mujore qe fillon ose perfundon ne vitin kalendarik perkates, dhe

b) shperblimi paguhet nga, ose ne emer te, nje punedhenesi qe

nuk eshte rezident i Shtetit tjeter, dhe

c) shperblimi nuk ka lindur nga nje seli e perhereshme ose baze fikse qe punedhenesi ka ne Shtetin tjeter.

3. Pamvaresisht nga dispozitat e mepareshme te ketij Neni, shperblimet e realizuara nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues lidhur me punen e ushtruar ne bordin e nje anije, avioni, mjeti te transportit hekurudhor apo rrugor qe ushtron aktivitet ne trafikun nderkombetar do te tathohen vetem ne Shtetin Kontraktues ne te cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv te siper marrjes.

#### **NENI 17**

##### **SHPERBLIMET E DREJTOREVE**

Shperblimet e drejtoreve dhe pagesa te tjera te ngjashme te realizuara nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues ne poziten e tij si anetar i keshillit te drejtoreve ose çdo organi te ngjashem te nje shoqerije qe eshte rezidente e Shtetit tjeter Kontraktues, mund te tathohen ne kete Shtet tjeter.

#### **NENI 18**

##### **ARTISTET DHE SPORTISTET**

1. Pamvaresisht nga dispozitat e neneve 15 dhe 16, te ardhurat e realizuara nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues si nje argetues si aktor theatri, kinematografie, radio-televizioni, muzikant apo sportist, nga aktiviteti i tij personal si i tille, i ushtruar ne Shtetin tjeter Kontraktues, mund te tathohen ne kete Shtet tjeter.

2. Kur te ardhurat lidhur me aktivitetet personale te ushtruara nga nje artist ose sportist ne poziten e tij si i tille realizohen jo direkt nga sportisti apo artisti por nga nje person tjeter, keto te ardhura, perjashtuar dispozitat e Neneve 7, 15 dhe 16, mund te tathohen ne Shtetin Kontraktues ne te cilin jane ushtruar aktivitetet e artistit apo sportistit.

3. Pamvaresisht nga dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2, te ardhurat e realizuara nga aktivitetet e kryera brenda kuadrit te shkembimeve kulturore ne baze te marreveshjeve kulturore te perfunduara midis dy Shteteve Kontraktuese, do te perjashtohen reciprokisht nga tatimet, vetem nese aktivitetet te tilla jane sponsorizuar nga Qeverija e nje Shteti Kontraktues dhe keto aktivitetet nuk zhvillohen per qellime fitimi.

#### **NENI 19**

##### **PENSIONET**



1. Duke mos cenuar dispozitat e paragrafit 2 te Nenit 20, pensionet dhe shperblime te tjera te ngjashme paguar nje rezidenti te nje Shteti Kontraktues lidhur me punesimin e tij ne te kaluaren do te tatohen vetem ne ate Shtet.

2. Pamvaresisht nga dispozitat e paragrafit 1, pensionet e paguara dhe te tjera pagesa te bera nen nje skeme publike qe eshte pjese e sistemit te sigurimeve shoqerore te nje Shteti Kontraktues apo nje autoriteti lokal, do te tatohen vetem ne ate Shtet.

## **NENI 20**

### **SHERBIMET QEVERITARE**

1. a) Shperblimet e tjera veç pensioneve, paguar nga nje Shtet Kontraktues ose nga nje autoritet lokal nje individi lidhur me sherbimet e kryera atij Shteti ose autoriteti lokal do te tatohen vetem ne ate Shtet.

b) Megjithate, keto shperblime mund te tatohen vetem ne Shtetin tjeter Kontraktues nese sherbimet jane kryer ne kete Shtet tjeter rezident i te cilit eshte individi, i cili:

(i) eshte nenshtetas i atij Shteti; ose

(ii) nuk eshte bere rezident i atij Shteti vetem per qellim te kryerjes se sherbimeve.

2. a) Çdo pension i paguar nga, ose prej fondeve te krijuara nga nje Shtet Kontraktues ose autoritet lokal, nje individi lidhur me sherbimet e kryera atij Shteti ose autoriteti lokal do te tatohen vetem ne ate Shtet.

b) Megjithate, keto pensione do te tatohen vetem ne Shtetin tjeter Kontraktues nese individi eshte rezident dhe neneshtetas i atij Shteti.

3. Dispozitat e neneve 16, 17 dhe 19 do te zbatohen mbi shperblimet dhe pensionet lidhur me sherbimet e kryera lidhur me nje aktivitet biznesi te ushtruar nga nje Shtet Kontraktues ose autoritet lokal.

## **NENI 21**

### **STUDENTET DHE SPECIALIZANTET**

1. Pagesat qe nje student apo specializant qe eshte ose ishte menjehere para ardhjes ne nje Shtet Kontraktues rezident i Shtetit tjeter Kontraktues dhe qe eshte prezent ne Shtetin e permendur ne fillim vetem per qellim te arsimimit ose specializimit te tij nuk do te tatohet ne ate Shtet per nje periudhe 7 vjeçare, me kusht qe keto pagesa kryhen nga burime jashte ketij Shteti Kontraktues.

2. Persa i perket ndihmave, bursave dhe shperblimeve nga punesimi qe nuk mbulohen nga paragrafi 1, studenti ose specializanti i pershkruar ne paragrafin 1, gjate arsimimit ose specializimit do te gezoje te njejtat perjashtime, lehtesira ose reduktime tatimore qe gezojne rezidentet e Shtetit te cilin ai viziton.

3. Te ardhurat e realizuara nga nje student ose specializant lidhur me aktivitetet e ushtruara ne nje Shtet Kontraktues gjate qendrimit te tij ne ate Shtet per arsimim apo specializim do te perjashtohen nga tatimi ne ate Shtet per shumat qe nuk i kalojne 3500 dollare Amerikane ne vitin kalendarik perkates.

## **NENI 22**

### **PETAGOGET DHE KERKUESIT SHKENCORE**

1. Nje individ qe eshte ose ishte rezident i nje Shteti Kontraktues menjehere perpara kryerjes se nje vizite ne Shtetin tjeter Kontraktues dhe qe, me ftese te nje universiteti, kolegji, shkolle apo institucioni tjeter arsimor te ngjashem jofitimprures, qe eshte i njohur nga Qeverija e ketij Shteti tjeter Kontraktues, eshte prezent ne kete Shtet tjeter Kontraktues per nje periudhe qe nuk i kalon dy vjet nga data e ardhjes se tij te pare ne kete Shtet Kontraktues per qellimin e vetem te mesimdhenjes, kerkimit shkencor, apo te te dyjave ne keto institucione arsimore do te perjashtohet nga tatimi ne kete Shtet tjeter Kontraktues per te ardhurat e tij nga mesimdhenja apo kerkimi shkencor.

2. Dispozitat e paragrafit 1 te ketij Neni nuk do te zbatohen ndaj te ardhurave nga kerkimet shkencore nese te tilla kerkime jane ndermarre jo per interesat publike, por per perfitime private te nje personi apo personave te vecante.

## **NENI 23**

### **TE ARDHURA TE TJERA**

1. Lloje te te ardhurave te nje rezidenti te nje Shteti Kontraktues, kudo qe te krijohen, qe nuk lidhen me artikujt e meparshem te kesaj Konvente do te taten ne ate Shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do te zbatohen ndaj te ardhurave, te ndryshme nga te ardhurat nga pasuria e patundshe te percaktuara ne paragrafin 2 te Nenit 6, nese perfituesi i ketyre te ardhurave, duke gene rezident i nje Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet ne Shtetin tjeter Kontraktues nepermjet nje selie te perhereshme te vendosur aty, ose kryen ne ate Shtet tjeter sherbime personale te pavarura nga nje baze fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose pasuria lidhur me te cilen paguhet shperblimi eshte efektivisht e lidhur me kete seli te perhereshme ose baze fikse. Ne kete rast do te zbatohen dispozitat e Nenit 7 ose 15, si te paraqitet rasti.

3. Pamvaresisht nga dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2, lloje te te ardhurave te nje rezidenti te nje Shteti Kontraktues qe nuk lidhen me Nenet e meparshme te kesaj Konvente dhe qe krijohen ne Shtetin tjeter Kontraktues mund te tatohen gjithashtu ne kete Shtet tjeter.

## **NENI 24**

### **TATIMI I KAPITALIT**

1. Kapitali i perfaqsuar nga pasuri te patundeshme qe i referohen Nenit 6, te zoteruara nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues dhe te vendosura ne Shtetin tjeter Kontraktues, mund te tatohen ne kete Shtet tjeter.

2. Kapitali i perfaqsuar nga pasuri te tundshme qe bejne pjese ne pasurine e aktivitetit te nje selie te perhereshme qe nje sipermarrje ose nga pasuri te tundshme qe i perkasin nje baze fikse te perdorur per kryerjen e sherbimeve personale te pavarura, mund te tatohen ne Shtetin Kontraktues ne te cilin ndodhet selija e perhereshme ose baza fikse.

3. Kapitali i perfaqsuar nga anijet, avionet, mjete te transportit hekurudhor apo rrugor qe veprojne ne trafikun nderkombetar, si dhe pasurite e tundeshme qe i perkasin aktivitetit te ketyre mjeteve te transportit do te tatohen vetem ne Shtetin Kontraktues ne te cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv te sipermarrjes.

4. Te gjithë elementet e tjere te kapitalit te nje rezidenti te nje Shteti Kontraktues do te tatohen vetem ne kete Shtet.

## **NENI 25**

### **ELEMINIMI I TATIMIT TE DYFISHTE**

1. Ne rastin e Shqiperise, tatimi i dyfishte do te eleminohet si vijon:

a) Kur nje rezident i Shqiperise realizon te ardhura ose zoteron kapitale te cilat, ne perputhje me dispozitat e kesaj Konvente mund te tatohen ne Rumani, Shqiperia do te lejoje nje reduktim nga tatimi i saj mbi te ardhurat e ketij rezidenti, te nje shume te barabarte me tatimin mbi te ardhurat te paguar ne Rumani dhe nje reduktim nga tatimi i saj mbi kapitalin e atij rezidenti, te nje shume te barabarte me tatimin mbi kapitalin te paguar ne Rumani. Megjithate, ky reduktim nuk do te kaloje ate pjese te tatimit shqiptar mbi te ardhurat ose kapitalin te llogaritur para dhenies se reduktimit qe i atribuohet sipas rastit, te ardhurave ose kapitalit qe mund te tatohet ne Rumani.

b) Kur ne perputhje me dispozitat e kesaj Konvente, te ardhurat e realizuara ose kapitali i zoteruar nga nje rezident i Shqiperise perjashtohet nga tatimi ne Shqiperi, ne llogaritjen e shumes se tatimit mbi te ardhurat ose kapitalin e mbetur te ketij rezidenti, Shqiperia merr parasysht te ardhurat ose kapitalin e perjashtuar.

2. Ne rastin e Rumanise, tatimi i dyfishte do te eleminohet si vijon:

a) kur nje rezident i Rumanise realizon te ardhura ose zoteron kapitale te cilat ne perputhje me dispozitat e kesaj Konvente taten ne Shqiperi, atehere Rumanija do te perjashtoje nga tatimi keto te ardhura apo kapitale - pervec te ardhurave te permendura ne paragrafin b) - dhe ne percaktimin e nivelit te tatimit merr parasysht te ardhurat e realizuara ne total, duke e aplikuar kete nivel tatimi vetem ne pjesen e mbetur te te ardhurave.

b) kur nje rezident i Rumanise realizon lloje te te ardhurave qe ne perputhje me dispozitat e Neneve 10, 11, 12 dhe 13 mund te taten ne Shqiperi, atehere Rumanija do te lejoje nje reduktim nga tatimi mbi te ardhurat e atij rezidenti te nje shume te barabarte me tatimin e paguar ne Shqiperi. Megjithate, ky reduktim nuk do te kaloje ate pjese te tatimit te llogaritur perpara dhenjes se reduktimit, qe i atribuohet te tilla llojeve te te ardhurave nga Shqiperija.

## **NENI 26**

### **MOS-DISKRIMINIMI**

1. Neneshtetasit e nje Shteti Kontraktues nuk do te jene, ne Shtetin tjeter Kontraktues, subjekt i ndonje tatimi ose kerkese te lidhur me te qe te jete i ndryshem ose me i rende se sa tatimi ose kerkesat e lidhura me te te cilave i neneshtrohen neneshtetasit e ketij Shteti tjeter ne rrethana te njejta. Kjo dispozite, pamvaresisht nga dispozitat e Nenit 1, do te zbatohet gjithashtu ndaj personave qe nuk jane rezidente te njerit apo te asnjorit prej Shteteve Kontraktues.

2. Tatimi i nje selie te perhereshme qe nje sipermarrje e nje Shteti Kontraktues ka ne Shtetin tjeter Kontraktues nuk do te jete me pak i favorshem ne kete Shtet tjeter se sa tatimi i ngarkuar ndaj sipermarrjeve te ketij Shteti tjeter qe ushtrojne aktivite te njejta. Dispozitat e ketij Neni nuk do te merren si detyrim i njerit Shtet Kontraktues per t'i garantuar rezidenteve te Shtetit tjeter Kontraktues lehtesime personale apo reduktime tatimore qe i garanton

rezidenteve te Shtetit te vet per gjendjen civile dhe pergjegjesite familiare qe ata kane.

3. Perjashtuar rastet kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 te Nenit 9, paragrafit 8 te Nenit 11 ose paragrafit 6 te Nenit 12 dhe 13, interesat, komisionet, honoraret dhe shperblime te tjera te paguara nga nje sipermarrje e nje Shteti Kontraktues nje rezidenti te Shtetit tjeter Kontraktues, per efekt te percaktimit te fitimeve te tatueshme te kesaj sipermarrje, do te jene te reduktueshme nen te njejtat kondita njelloj sikur ato t'i paguheshin nje rezidenti te Shtetit te permendur ne fillim. Ne menyre te ngjashme çdo borxh i nje sipermarrje te nje Shteti Kontraktues ndaj nje rezidenti te Shtetit tjeter Kontraktues, per efekt te percaktimit te kapitalit te tatueshem te kesaj sipermarrje, do te jete i reduktueshem nen te njejtat kondita njelloj sikur sipermarrja te kishte kontraktuar me nje rezident te Shtetit te permendur ne fillim.

4. Sipermarrjet e nje Shteti Kontraktues, kapitali i te cilave eshte totalisht ose pjeserisht i zoteruar apo kontrolluar, direkt ose indirekt nga nje ose me shume rezidente te Shtetit tjeter Kontraktues, nuk do te jene ne Shtetin e permendur ne fillim subjekt i ndonje tatimi ose kerkesa te lidhur me te, qe te jete me i rende se sa tatimi ose kerkesat e lidhura me te, te cilave i neneshtrohen sipermarrje te tjera te ngjashme te Shtetit te permendur ne fillim.

5. Dispozitat e ketij Neni, pamvaresisht nga dispozitat e Nenit 2, do te zbatohen ndaj tatimeve te çdo lloji.

## **NENI 27**

### **PROCEDURA E MIREKUPTIMIT RECIPROK**

1. Kur nje person mendon se veprimet e njerit apo e te dy Shteteve Kontraktuese e rendojne apo do ta rendojne ate me tatime qe nuk jane ne perputhje me dispozitat e kesaj Konvente, pamvaresisht nga menytrat e ankimit te parashikuara ne legjislacionin e brendeshem te ketyre Shteteve, ai mund t'ja paraqese rastin e tij autoriteteve kompetente te Shtetit Kontraktues rezident i te cilit ai eshte, ose nese rasti lidhet me paragrafin 1 te Nenit 26, ai mund t'ja paraqese rastin Shtetit Kontraktues neneshtetas i te cilit ai eshte.

Çeshtja duhet te paraqitet brenda tre vjeteve nga njoftimi i pare lidhur me tatimin qe nuk eshte ne perputhje me dispozitat e Konventes.

2. Autoriteti kompetent, nese kerkesa i duket e justifikuar dhe ai vete nuk e ka te mundur arritjen e nje zgjidhje te kenaqshme, do te perpiket t'a zgjidhe çeshtjen me mirekuptim reciprok me autoritetin kompetent te Shtetit tjeter Kontraktues, me synim shmangjen e tatimit qe nuk eshte ne perputhje me dispozitat e Konventes. Çdo marreveshje e arritur do te zbatohet pamvaresisht

nga kufijte kohore qe mund te parashikoje legjislacioni i brendeshem i Shteteve Kontraktues.

3. Autoritet Kompetente te Shteteve Kontraktues do te perpigen te qe me mirekuptim reciprok te zgjidhin çdo veshtiresi apo dyshim qe lind nga interpretimi apo zbatimi i kesaj Konvente. Ato gjithashtu mund te konsultohen se bashku per eleminimin e tatimit te dyfishte ne rastet kur nje gje e tille nuk parashikohet nga Konventa.

4. Autoritet kompetente te Shteteve Kontraktues mund te komunikojne me njeri tjetrin direkt per arritjen e mirekuptimit ne kuptimin e paragrafeve te mesiperm. Kur shihet e arsyeshme ne menyre qe te arrihet mirekuptimi, perfaqsesit e autoriteteve kompetente te Shteteve Kontraktuese mund te zhvillojne diskutime direkte.

## **NENI 28**

### **SHKEMBIMI I INFORMACIONIT**

1. Autoritetet kompetente te Shteteve Kontraktues do te shkembejne informacionet e nevojshme per zbatimin e dispozitave te kesaj Konvente ose te ligjeve te brendeshme te Shteteve Kontraktuese lidhur me tatimet qe mbulon Konventa, perderisa ato tatime nuk jane ne kundërshtim me Konventen. Shkembimi i informacionit nuk kufizohet nga Neni 1. Çdo informacion i marre nga nje Shtet Kontraktues do te trajtohet si sekret, ne te njejten menyre si informacioni i marre nen legjislacionin e brendeshem te atij Shteti dhe do t'i serviret vetem personave apo autoriteteve (perfshire gjykatat dhe organet administrative) te perfshira ne llogaritjen apo mbledhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore apo lidhur me ankesat ndaj tatimeve qe mbulon Konventa. Keto persona apo autoritete do ta perdorin informacionin vetem per te tilla qellime. Ato mund ta servirin informacionin ne procedurat apo vendimet gjygesore.

2. Ne asnje rast dispozitat e paragrafit 1 nuk te interpretohen ne kuptimin qe i imponojne njerit prej Shteteve Kontraktues detyrimin:

a) te zbatoje masa administrative ne ndryshim me ligjet dhe praktikat administrative te atij Shteti apo te Shtetit tjetër Kontraktues;

b) te jape informacione qe ndalohen sipas ligjeve apo praktikes normale administrative te atij Shteti apo te Shtetit tjetër Kontraktues;

c) te jape informacione qe mund te nxirrnin nje sekret tregtar, industrial apo profesional apo informacione, komunikimi i te cilave do te ishte ne kundërshtim me rendin publik.

## **NENI 29**

### **FUNKSIONARET DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE**

Dispozitat e kesaj Konvente nuk cenojne privilegjet fiskale te funksionareve diplomatike dhe konsullore qe rrjedhin nga rregullat e pergjithshme te se drejtes nderkombetare apo nga dispozita te Marreveshjeve te vecanta.

## **NENI 30**

### **HYRJA NE FUQI**

1. Kjo Konvente do te ratifikohet ne te dy Shtetet Kontraktuese dhe instrumentat e ratifikimit do do te shkembihen sa me shpejt qe te jete e mundur.

2. Konventa do te hyje ne fuqi me shkembimin e instrumentave te ratifikimit dhe dispozitat e saj do te kene efekt lidhur me te ardhurat e realizuara ose kapitalin e zoteruar me ose pas dites se pare te Janarit te vitit kalendarik qe ndjek ate te hyrjes ne fuqi te Konventes. Per qellimet e Nenit 26 (shkembimi i informacionit), dispozitat do te kene efekt me dhe pas dates se hyrjes ne fuqi te Konventes.

## **NENI 31**

### **PERFUNDIMI**

Kjo Konvente do te mbetet ne fuqi deri ne denoncimin nga njeri Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund te perfundoje Konventen, pas 5 vjeteve pas hyrjes se saj ne fuqi duke dhene njoftimin e perfundimit, nepermjet kanaleve diplomatike, te pakten 6 muaj perpara perfundimit te çdo viti kalendarik. Ne kete rast, Konventa do te pushoje se pasuri efekt lidhur me te ardhurat e realizuara ose kapitalin e zoteruar me ose pas dites se pare te Janarit te vitit kalendarik qe ndjek vitin ne te cilin eshte dhene njoftimi i perfundimit.

Bere ne dy kopjo, ne Bukuresht, me 11 Maj 1994 ne gjuhen Shqipe, Rumune dhe Angleze, te tria tekstet kane vlera te barabarta. Ne raste divergjencash midis teksteve, teksti ne gjuhen angleze do te kete perparesi.

PER QEVERINE E  
REPUBLIKES SE SHQIPERISE  
Piro DISHNICA

PER QEVERINE E  
RUMANISE  
Florin GEORGESCU